

KËRKIME GJUHËSORE

Anila DODA

SISTEMI VOKALIK NË TË FOLMEN E DIBRËS

Studimi i të folmes së Dibrës, paraqet interes në fushën e dialektologjisë për njohjen e begatisë së fenomeneve të ndryshme fonetike-fonologjike, morfologjike e leksikore. Në aspektin gjuhësor e folmja e Dibrës në përgjithësi përkon me të folmen e gegërishtes verilindore. Mirëpo në këtë të folme gjejmë edhe disa veçori që janë specifike për të.

Sistemi vokalik i të folmes së Dibrës ka dy radhë fonemash zanore gojore dhe dy radhë fonemash zanore hundore, *1. zanore gojore* të shkurtra dhe të gjata dhe *2. zanore hundore* të shkurtra dhe të gjata

Gjatësia e zanoreve. Zanoret e gjata ekzistojnë në disa të folme të kësaj zone ndërsa në disa të tjera mungojnë fare. E. Çabej, në punimin e tij “Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes” konsiston se në gjatësinë dhe shkurtësinë e një zanoreje në gjuhën shqipe nuk luan rol aq të madh theksimi i saj, as vendi që ajo ka brenda fjalës, sa peshon një kriter historik – pra kjo gjatësi është vazhdimësi e një gjatësie të hershme. Dukurinë e gjatësisë së zanoreve e ka trajtuar edhe M. Çeliku, i cili konstaton se kuantiteti i zanoreve në të folmet e ndryshme geqe, ka vlerë dalluese, e cila nuk varet nga rrethana fonetike.

Lidhur me gjatësinë e zanoreve edhe Rexhep Ismajli në punimin e tij për kuantitetin e zanoreve i kundërshton tezën e disa gjuhëtarëve siç është Trubeckoi, të cilët pohojnë se në gjuhën shqipe nuk ekziston kundërvënja në gjatësinë e zanoreve. Rezultate me interes për gjatësinë e zanoreve në të folmen verilindore ka dhënë edhe Idriz Ajeti.

Gjatësia e zanoreve në gjuhën shqipe në përgjithësi është karakteristik për të folmet geqe dhe për të folmet e çamërishtes e të labërishtes për dialektin toskë por në këto të folme mund të themi se zanoret e gjata nuk i gjejmë dendur si në dialektin e gegërishtes.

Gjatësia e zanoreve në të folmen e Dibrës është sa interesante aq edhe e vështirë për ta studiuar, pasi mungesa e mjeteve teknike të fonetikës eksperimentale e vështirëson studimin e kësaj dukurie. Në përgjithësi në të folmet e Dibrës, por edhe në të folmet e tjera përreth, **zgjatja e zanoreve** është një dukuri **e përhershme**. Kjo dukuri fonetike ka shkuar aq larg sa që në një pjesë të kësaj treve, për shkak të gjatësisë së zanoreve, **ka humbur kundërvënja** zanore e gjatë-zanore e shkurtër.

Gjithashtu kjo gjatësi nuk është unike për mbarë të folmen e Dibrës për shkak se ajo ndryshon edhe brenda për brenda vetë këtij sistemi. Pra në të folmen e Dibrës ashtu si dhe në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, zanoret e theksuara kanë tri shkallë të gjatësisë së zanoreve: *të gjata, të mesme, të shkurtra*. Ashtu si edhe në të folmet e tjera geqe, edhe në të folmen e Dibrës, gjatësia e zanoreve nuk kushtëzohet nga pozita fonetike, sepse ato i gjejmë para bashkëtingëlloreve të ndryshme dhe në pozicion të ndryshëm.

Zanoret e gjata në të folmen tonë i ndeshim në rrokje të theksuara fundore. Kjo gjatësi është rezultat i reduktimit të *ë-së* së patheksuar fundore. Pjesa më e madhe e këtyre fjalëve u përkasin emrave të gjinisë femërore, disa mbiemrave dhe një numër i vogël i tyre janë emra të gjinisë mashkullore, p.sh. *i gja:t, dja:l, dardh, gju:m, da:rk*.

Ashtu si edhe në të folmet e tjera geqe, edhe në të folmen e Dibrës gjatësia e zanoreve kushtëzohet edhe nga **monoftongimi i diftongjeve**. Kështu gjatë procesit të monoftongimit kemi rënien e një tingulli prandaj si pasojë e kësaj kemi zgjatjen e zanores si p.sh.: *di:ll, mi:ll, blu:j, du:j, etj.*

Zanore të gjata në të folmen tonë janë edhe ato zanore që ndiqen nga një bashkëtingëllore *r* ose *ll* p.sh.: *katuna:r, zaga:r, kuma:r, ma:ll, za:ll, ka:ll*.

Në rrokje të hapur zanoret e gjata zakonisht hetohen te këto fjalë: *ka:, gra:, za: etj.*

Me zanore të gjata si në rrokje të hapur ashtu edhe në rrokje të mbyllur, shqiptohet një numër i konsideruar fjalësh të huazuara nga gjuhët orientale si p.sh.: *ço:she, da:jre, ka:fe, tene:çe, ga:jle, pa:sh, ha:xh, a:g, etj.*

Zanoret e theksuara shqiptohen të gjata në mënyrë veçantë, atëherë kur shoqërohen me një bashkëtingëllore hundore dhe kur te këto fjalë kemi rënien e zanores *ë* si p.sh.: *za:n, gërsha:n, bru:m*.

Po kështu me zanore të gjatë na dalin edhe disa folje në vetën e parë dhe të tretë shumës në mënyrën dëftore si: *puno:jm, shko:jm, lexo:jm, lu:jm etj.* Zanore të gjata në rrokje të theksuar të mbyllur dalin fjalët njërrrokëshe si: *bu:rr, gja:l, pi:n, rri:n etj.* Zanore të gjata në rrokje të theksuara kemi vërejtur edhe disa folje të vetës së tretë njëjës të mënyrës dëftore si fjalët: *ha:n, tha:n, ma:n etj.*

Në rrokje të hapur zanoret e gjata i gjejmë: *vlla:, ha:, shka: etj.* Zanoret e gjata me rrokje fundore i ndeshim edhe te fjalët: *dhe:, be:, le:, (me pre):, etj.*

Po ashtu në rrokje të hapur zanoret me gjatësi i ndeshim te këto fjalë: *burri:, morri:, taxhi:, allti: etj.*

Zanoret e mesme nuk hynë në kundërvënien prandaj, ashtu si në mbarë të folmet geqe të shqipes, nuk kanë vlerë fonologjike, apo siç thekson Rexhep Ismajli, gjatësia e mesme e zanoreve është gjatësi asnjënjëse Zanoret e mesme në të folmen e Dibrës përftohen nga zgjatimi i zanoreve të shkurtra dhe shkurtimi i zanoreve të gjata. Kështu zanoret e gjata kalojnë në të mesme kur fjalës i shtohet një rrokje prapa: *rinia, liria, ushtria*.

Zanoret e shkurtra ashtu si dhe në të folmet e tjera geqe edhe në këtë të folme i ndeshim kryesisht te fjalët njërrrokëshe si: *lis, kos, mal, etj.* Zanoret e shkurtra i hasim edhe në rrokje të theksuar të mbyllur, kur shoqërohen nga një bashkëtingëllore e shurdhët: *zog, qak, flak, fat, lis, shtrat etj.*

Zanoret e shkurtra në rrokje të mbyllur te fjalët njërrrokëshe: *larg, shkurt, dal, shkop etj.* Të shkurtra në rrokje të theksuar janë edhe disa fjalë të mënyrës urdhërore: *mat, lip, hip*. Gjithashtu në rrokje të mbyllur te fjalët njërrrokëshe zanoret shqiptohen të shkurta si: *pak, lak, sôt etj.*

Po ashtu zanore të shkurtra në të folmet e Dibrës dëgjohen edhe tek emrat *spec, lôt, beg* fjalë që herë-herë i ndeshim si të mesme.

Pra, mund të përfundojmë se kuantiteti i zanoreve ka vlerë fonologjike, kështu p.sh. gjatësia e zanoreve i dallon foljet e vetës së parë: *ha, di, pi* nga foljet e vetës së trete: *ha, di, pi*. Fonologjikisht dallohen edhe emrat e gjinisë mashkullore: *qak, zog, kunat*, prej emrave të gjinisë femërore: *(pl)qa:k, zo:g, kuna:t*, etj

HUNDORËSIA E ZANOREVE (NAZALIZIMI). Njëra ndër dukuritë më të rëndësishme dhe me karakter diferencues për të folmet e shqipes është, pa dyshim, edhe hundorësia e zanoreve. Kjo dukuri në gjuhën shqipe ka ngjallur interesimin e shumë albanologëve të vendit e të huaj. Secili gjuhëtar që ka pretenduar, në një mënyrë, të merret me dialektologjinë shqiptare, si në vështirimin sinkronik, ashtu edhe në atë diakronik, nuk ka lënë pa trajtuar edhe këtë fenomen me interes të veçantë për dialektologjinë shqiptare.

Problematika e hundorësisë së zanoreve nuk është trajtuar njësoj nga të gjithë gjuhëtarët. Mendimet e tyre për këtë fenomen gjuhësor kanë qenë të ndryshme e herë-herë edhe kontradiktore. Pyetjes të cilës duhet ti jepet përgjigje ishte nëse dukuria e nazalizimit në gjuhën shqipe është zhvillim i brendshëm i kësaj gjuhe, apo është dukuri gjuhësore që është ndikuar nga gjuhët e tjera me të cilat shqipja ka qenë në kontakt dhe nëse është nazalizimi vetëm tipar i gegërishtes, apo dikur ky fenomen gjuhësorë është shtrirë edhe në të folmet e toskërishtes.

Shumica e gjuhëtarëve mbrojnë mendimin se nazalizimi është dukuri e zhvillimit të brendshëm të shqipes, pastaj disa të tjerë mendojnë se fenomeni i nazalizimit është i ndikuar prej rumanishtes, ndërsa ka edhe të tillë që mendojnë se në hundorësinë e zanoreve kane ndikuar edhe gjuhët sllave.

Për Nobert Joklin nazalizimi është proces fonetik që është shfaqur para ardhjes së sllavëve në Gadishullin Ballkanik. Ai mendon se dukuria e nazalizimit ka qenë e përhapur edhe në të folmet e dialektit të toskërishtes.

Pikëpamjen se nazalizimi në gjuhën shqipe ka lidhje me rumanishten e përkrah edhe Eqrem Çabej. Çabej thekson se nazalizimi vështirë të jetë këtu një dukuri e ruajtjes, konservimit dhe një proces i gjithëmbarshtëm i gjuhës, porse është një risi, një inovacion, relativisht i ri, i gegërishtes, i kryer mbase në mesjetën e hershme.

Kolec Topalli mendon se gjurmët e hundorësisë së zanoreve në disa të folme të toskërishtes (Labëri e Çamëri), që dallohen për karakterin e tyre ruajtës (konservativ), nuk mund të jetë një shfaqje e re e atyre të folmeve, sepse hundorësia aty ka përfshirë disa fjalë që, si të tilla, hasen edhe në dialektin verior, por jo ato që kanë hyrë në gjuhën shqipe në kohë më të vona, kur kishte përfunduar ky proces.

Në përgjithësi është pranuar se hundorësia e zanoreve në gjuhën shqipe është fenomen gjuhësorë i brendshëm i gjuhës shqipe, që është zhvilluar disa shekuj më parë dhe një proces që ka përfunduar para ardhjes së sllavëve në Gadishullin Ballkanik. Këtë e dëshmojnë edhe shumica e fjalëve me origjinë sllave, të cilat në gjuhën shqipe na dalin të panazalizuara.

Duhet thënë se sistemi i zanoreve hundore është karakteristikë e dialektit verior në gjuhën shqipe, por disa të folme të këtij dialekti, si kundër janë ajo e Ulqinit dhe e Dibrës, kanë shkuar kah çhundorëzimi i zanoreve.

Pra, nga veçoritë kryesore që vihen re në makrosistemin e zanoreve të theksuara të të folmeve të gjuhës shqipe konsiderohet prania në të folmen e dialektit të veriut (gegërishtes) **kundërvënia ndërmjet fonemave të theksuara hundore me ato gojore**. Sipas vrojtimit që i kemi bërë në terren kemi konstatuar se tek e folmja e Dibrës, ashtu si edhe te të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, ka një radhë fonemash hundore që u kundërvihen gojoreve, të cilat ndërmjet tyre krijojnë opozicione fonologjike. Shkak kryesor i krijimit të këtyre zanoreve hundore në këtë të folme është veprimi i bashkëtingëlloreve hundore mbi zanoret që ndodhen pranë. Në përgjithësi shkaktar i krijimit të zanoreve hundore, ashtu si në mbarë të folmet geqe janë bashkëtingëlloret hundore *m,n,j* (nj).

Mund të thuhet se hundorësia e zanoreve nuk kushtëzohet gjithnjë nga prania e bashkëtingëlloreve hundore, sepse te një grup fjalësh, edhe pse zanorja nuk ndiqet nga një bashkëtingëllore hundore, kemi shfaqjen e nazalizimit. Zanoren e theksuar *a* shpeshherë e gjejmë të labializuar, saqë, për shkak të labializimit të madh dëgjohet edhe si *o* p.sh.: *a'mël, ta'mël, shka'm, dra'm, tha'm, dha'm, ba'm, la'm, ka'm* etj. Kjo *o* nazale është rezultat i evoluimit të *a*-së hundore të mbyllur që shkon drejt *o*-së.

Zanoret hundore në të folmen që e kemi për objekt studimi i ndeshim në këto pozicione:

1. Para bashkëtingëlloreve hundore,
2. Pas bashkëtingëlloreve hundore,
3. Në mes të bashkëtingëlloreve hundore,
4. Hundorësia sipas analogjisë.

Zanoret hundore në të folmen e Dibrës i ndeshim para bashkëtingëlloreve te këto fjalë:

para bashkëtingëllores *m* : *a'mël, ta'mël, frëj'm*, etj.

para bashkëtingëllores *n* : *gun, zhgun, zun, p'an, guni, gruni*, etj.

para bashkëtingëllores *j*(nj): *fta'j, tha'j, gërdha'j, arrna'j, prra'j, drapa'j, nrra'j, ka'j, ma'j* etj.

Dukuria e hundorësisë së zanoreve para bashkëtingëlloreve hundore është një rregull i përgjithshëm për mbarë të folmet e dialektit gegë. Në bazë të hulumtimeve që i kemi bërë në terren, kemi konstatuar se në të folmen e Dibrës hundorësia e zanoreve na shfaqet edhe pas bashkëtingëlloreve hundore p.sh.: *una'z, ma'xhe, mi'z*.

Zanoret hundore i kemi hasur edhe në mes të bashkëtingëlloreve hundore, madje në këtë pozicion zanorja hundore shquhet me një intensitet më të fortë, krahasuar me pozicionin para dhe pas bashkëtingëlloreve hundore p.sh.: *na'na, ha'na, mi'ni, ve'ni, ma'jmoni* etj. Po ashtu zanoret hundore në të folmen që po shqyrtojmë i ndeshim në pozicion para bashkëtingëlloreve hundore të përfituara nga asimilimi i grupeve konsonantike *mb, nd, ng*, p.sh.: *shka'm, me ha'nër, dha'm, men, dhen, shllun, shem* etj. Po kështu mund të jenë hundore edhe pas

SISTEMI VOKALIK NË TË FOLMEN E DIBRËS

bashkëtingëlloreve të tilla, si: *me mush, me nja, nusht, musht* etj. Gjithashtu në të folmen e Dibrës kemi shfaqje të dukurisë së nazalizimit tek ato fjalë, në të cilat ka ekzistuar një bashkëtingëllore hundore, por që ka rënë në fund të fjalës, p.sh.: *söj/ëj, za, fröj*.

Te një numër i vogël i fjalëve kemi shfaqjen e nazalizimit si dukuri e analogjisë, p.sh.: *kusëj, fruthi, lethi* etj. Edhe te këto fjalë, të cilat nuk prihen as nuk ndiqen nga bashkëtingëlloret hundore, duhet të ketë pasur zanore të tilla hundore, por që kanë rënë prej kohësh, apo siç thekson Kolec Topalli: “Meqenëse zanoret hundore janë krijuar nga bashkëjetesa me bashkëtingëlloret hundore, kudo ku ka zanore hundore duhet të ketë ose të ketë pasur zanore të tilla.”

Në të folmen e Dibrës kemi tri radhë fonemash hundore: të gjata, të mesme dhe të shkurtra. Pra, krahas zanoreve të gjata kemi edhe zanore të shkurtra, të cilat i kundërvihen njëra-tjetrës. Kështu, zanoret e gjata hundore me zanoret e shkurtra hundore ndërmjet tyre krijojnë opozicione fonologjike, ndërsa sa u përket zanoreve të mesme, siç ka theksuar Rexhep Ismajli, janë të gjatësisë asnjënjëse, prandaj edhe nuk hynë në radhën e kundërvënieve.

Deri vonë ka ekzistuar mendimi se fenomeni i nazalizimit i ka përfshirë vetëm zanoret e gjata. Këtë mendim e kishte edhe gjuhëtari polak Vaclav Cimochoviski. Me gjithë mendimin e Cimochoviskit, Ismajli pohon se kundërvënia zanore e shkurtër-zanore të gjatë kemi edhe në radhë të hundoreve.

Zanoret e gjata hundore në këtë të folme dëgjohen në rrokje të hapur fundore te këto fjalë: *hu, dru, tru, mullëj, kufëj*, etj.

Zanoret e shkurtra në të folmen tonë hasen në rrokje të mbyllur te fjalët njërrrokëshe, si p.sh.: *ma'z, rra'z, a'sht, sen, men, ven, bun, la'n, ka'n*, etj.

Ashtu siç kemi theksuar edhe për zanore gojore, edhe zanoret hundore gjatë fleksionit, kur u shtohet një rrokje, apo një tingull prapa, kalojnë në zanore të mesme: *za'ni, huni, druni, guni, peni* etj.

Opozicioni fonologjik i zanoreve hundore. Megjithëse kundërvënia e zanoreve hundore me zanoret gojore në të folmen që po shqyrtojmë nuk paraqet ndonjë veçori të theksuar në krahasim me të folmet e tjera, prapëseprapë ajo vlen të përmendet. Kështu, me anë të pranisë apo mospranisë së zanoreve hundore, i dallojmë fjalët: *uj - uj* (uria), *asht* (kockë) - *a'sht* (është) folje, *re* (grue e djalit) - *re* (vranësirë) etj.

Nazalizimi në të folmen tonë vërehet edhe te fjalët me prejardhje nga gjuhët orientale, sidomos kur zanorja gjendet para bashkëtingëlloreve hundore, p.sh.: *insa'n, zema'n, shejta'n, hava'n, jataga'n, tufa'n, hajva'n, derma'n, xhehnem* etj. Po ashtu, me zanore hundore shqiptohen edhe disa emra të përveçëm, të huazuar nga gjuhët orientale, si p.sh.: *Shaba'n, La'm, Isla'm, Kasu'm, Skener, Mazllum* etj.

DIFTONGJET DHE TOGJET VOKALIKE. Problematikat e diftongjeve dhe e grupeve vokaliqe në të folmet e shqipes kanë qenë objekt interesimi i shumë albanologëve. Mendimet lidhur me përhapjen e diftongjeve dhe të togjeve zanore kanë qenë të ndryshme. Në shumë raste kjo çështje nuk është shpjeguar sa duhet dhe si duhet. Arsyeja qëndron në faktin se, për t'i studiuar me

saktësi diftongjet dhe togjet e zanoreve, si në aspektin sinkronik ashtu dhe në atë diakronik, nevojitet një pasqyrë e qartë e përhapjes së tyre nëpër të folmet e ndryshme të shqipes.

Veçanërisht gjuhëtari ynë i madh, Eqrem Çabej, theksonte se diftongjet e kohës indoevropiane, të gjatat dhe të shkurtra, janë zhdukur duke u reduktuar në vokale të thjeshta, janë monoftoguar dhe anasjelltas shqipja ka krijuar diftongje të reja, ç'ka do të thotë se diftongjet e sotme janë sekondare. Sipas Kolec Topallit karakteristika e përgjithshme e diftongjeve është reduktim në një zanore të thjeshtë, por, sipas tij, është vështirë të përcaktohet lloji i zanores që ka dalë nga ky monoftongim. Gjithashtu, edhe për kohët kur ka vepruar kjo dukuri, gjuhëtarët shprehin mendime që nuk përputhen gjithnjë.

Çështjen e diftongjeve dhe togjeve zanore për të folmen e gegërishtes verilindore e kanë trajtuar edhe Idriz Ajeti, Latif Mulaku, Mehmet Halimi, Imri Badallaj, Fadil Raka, Ragip Mulaku, Shaqir Berani, Zijadin Munishi, Vediha Topçiu etj. Sa u përket diftongjeve dhe togjeve zanore në të folmen që po trajtojmë mund të konstatojmë se nuk ka ndonjë dallim të theksuar në krahasim me të folmet e tjera të gegërishtes verilindore. Meqenëse qëllimi im është të merrem me diftongjet dhe togjet e zanoreve në të folmen tonë, **vetëm në rrafshin sinkronik**, nuk do të merret me vështrimin e tyre në atë diakronik.

Diftongu *ue*. Për diftongun *ue* Çabej thekson se është rezultat i zhvillimit të togut të vjetër *uo*, që dikur ishte i përbashkët për mbarë të folmet e shqipes. Këtë e dëshmojnë edhe shkrimet e vjetra të gjuhës shqipe, si te: Buzuku, Budi, Bogdani etj. Si rezultat i zhvillimit të këtij togu janë diftongjet e sotme të shqipes në toskërisht *ua*, ndërsa në gegërisht *ue*. Në të folmen e Dibrës këtë diftong e gjejmë në dy forma; si diftong *ue* dhe të monoftonguar në *u*. Grupet vokalice ende nuk kanë përfunduar në vokale të gjata, ndërsa ai proces është duke u zhvilluar.

Diftongun *ue* në të folmen e Dibrës e ndeshim të ruajtur në rrokje të hapur tek emrat: *ftue*, *grue*, *prue*, etj. Këtë diftong e ndeshim edhe te format e pashtjelluara të këtyre foljeve: *kallxue*, *shtrue*, *punue*, *çue*, *vluë*, *me prue*, *me gatue* etj. Po ashtu këtë diftong e ndeshim të monoftonguar edhe në *u*, si p.sh.: *gru*, *ftu*, *me nrru*, *me shku*, *me duru*, *me fitu*. Diftongun *ue* të monoftonguar e gjejmë edhe te disa mbiemra që formohen nga pjesorja e foljeve, si p.sh., *i shkum*, *i m(b)ulum*, *e shkune*, *i harrum*, *i poshtnum* etj. Si diftong *ue* në të folmen në shqyrtim e gjejmë te përemri vetor *mue* (mu), ndërsa shumë më rrallë në formën *mu*, si të monoftonguar.

Në pozicion në rrokje të mbyllur fundore në të gjitha rastet këtë diftong e gjejmë të monoftonguar p.sh.: *gatu*, *pagju*, *(blu)gju*, *lu* etj. Në të folmen tonë, diftongun *ue* shqiptohet më shpesh i plotë, atëherë kur rrokja në të cilin del ky grup ndodhet në fund të fjalës dhe ky diftong është në pozitë fundore të hapur.

Shkaku i monoftongimit të diftongut *ue* qëndron në theksin e fjalës. Kështu, duke pasur rregullisht theks në elementin e parë të diftongut *ue*, elementi i dytë shkon kah zhdukja, duke e lënë pas një shkallë të gjatësisë.

Diftongu ye. Diftongu *ye* që është zhvilluar në shumë të folme të shqipës, siç dihet ka prejardhje prej një *e*-je të gjatë. Diftongu, kur ndodhet në trup të fjalës, në të shumtën e rasteve, del i shndërruar në *i* të gjatë, p.sh.: tek emrat: *tli:n, di:r, inej:r, fej:ll, di:ll* etj. Këtë diftong e ndeshim të shndërruar në *ëj / oj*, ose në *i* edhe te format e pashtjelluara të foljeve: *me grrëj / me grroj, me frëj / me frej, me li, / me nxhi, me pshtëj / me pshtoj*; etj.

Diftongu ie. Diftongu *ie* në të folmen tonë si dhe në të folmet e tjera të geqe në pozicionin në rrokje të mbyllur e ndeshim të monoftonguar në zanore të gjatë si p.sh.: *mi:ll, di:ll, ç:ll* etj. Te këto fjalë zanorja në rrokje të theksuar shqiptohet e gjatë si rezultat i procesit të monoftongimit pas rënies së gjysmëzanores *e*. Nga shembujt shihet qartë se në të folmen e Dibrës ky diftong është në fazën përfundimtare të procesit të monoftongimit në zanore të thjeshtë *i*. Arsyeja e monoftongimit të diftongut në fjalë qëndron në theksimin e fjalës në elementin e parë të diftongut.

Grupet vokalice ae, oe. Të folmet geqe largohen nga njëra-tjetra edhe në përdorimin e këtij togu zanor, varësisht prej vendit ku bie theksi, që do të thotë se, në qoftë se theksi bie mbi *o*-në e dyzanorshit *oe*, atëhere elementi i dytë i tij, duke qenë i patheksuar, me kohë do të bjerë e do të zhduket krejtësisht, ndërsa nëse theksohet pjesa e dytë me kohë do të sjellë zhdukjen e elementit të parë. Në të folmen e Dibrës këto grupe i hasim në dy forma si grupe vokalice dhe si vokale të thjeshta.

Për grupet vokalice *ae* dhe *oe* Çabej thekson se fonetikisht do të mendohet se grupet vokalice *ae,oe* nuk kanë kaluar direkt në vokalet të thjeshta, por se kalimi u bë nëpër diftongje, pra nëpër lidhje vokalice njërrrokëshe.

Togjet vokalice *ae, oe* i ndeshim rëndom te një numër i vogël foljesh të vetës së dytë të kohës së kryer të thjeshtë si p.sh.: *thae, lae, pae, rae, dhae*, kurse togun *oe* e ndeshim te disa emra si: *voe, droe* etj.

Grupi vokalik ae. Grupi vokalik *ae* në të folmen e Dibrës, ashtu si edhe në disa të folme të tjera të gegërishtes verilindore, e gjejmë të plotë p.sh.: *rae, pae, thae*, etj. Në raste më të rralla këtë grup vokalik e gjejmë të reduktuar në vokal të thjeshtë në formën: *pa:, ra:, ha:,* etj. ,por edhe me formën: *pe:, re:* etj. Ky grup është ruajtur edhe në të folmet e gegërishtes qendrore.

Grupi vokalik oe. Ashtu si edhe grupi *ae*, edhe këtë grup në të folmen tonë e gjejmë edhe si grup vokalik të paprekur, por edhe si vokal të rrudhur në zanore të thjeshtë. Si grup vokalik e ndeshim te *voe, droe*, këto fjalë në trajtën e shquar dalin me vokale të thjeshta si: *voja, droja*.

Si përfundim themi se e folmja e Peshkopisë dhe e Dibrës në përgjithësi është e pasur nga ana fonetike; dallojmë edhe zanoret e shkurtra gojore që krijojnë kundërvënien fonologjike me zanoret e gjata gojore. Pra, mund të përfundojmë se kuantiteti i zanoreve ka vlerë fonologjike.

Duhet thënë se sistemi i zanoreve hundore është karakteristikë e dialektit verior në gjuhën shqipe, por disa të folme të këtij dialekti, si kundër janë ajo e Ulqinit dhe e Dibrës, kanë shkuar kah çhundorëzimi i zanoreve. Megjithatë, nga veçoritë kryesore që vihen re në makrosistemin e zanoreve të theksuara konsiderohet

prania në të folmen e Dibrës e **kundërvënies ndërmjet fonemave të theksuara hundore me ato gojore.**

Gjithashtu, në të folmen e Dibrës i gjejmë të dy dukuritë; si diftongimin dhe monoftongimin. Grupet vokaliqe ende nuk kanë përfunduar në vokale të gjata, ndërsa ai proces është duke u zhvilluar.

Në fushën e zanoreve, elementi më interesant, që i jep një farë aspekti karakteristik të folmeve të Dibrës, është zanorja *i* e theksuar. Në këtë krahinë ndihet me këto nuanca: *i* e pastër, *è*, *èj*, *aej*, *aj*, *a*, si dhe në çdo rast ajo zëvendëson zanoren *y*, ashtu si në çamërishte. Të përcaktosh me saktësi shkallën e zhvillimit të secilit prej këtyre tingujve, pa mjete teknike dhe pa një punë laboratorie, është e pamundur. Gjithashtu e vështirë është të vësh një kufi të prerë në mes sferave të përhapjes së secilit prej këtyre zhvillimeve, pasi nuk i gjejmë me trajta të kristalizuara dhe të qëndrueshme. E njëjta fjalë, në të njëjtin lokalitet, shqiptohet ndryshe (mër, edhe maër, nëij, edhe naej, etj.).

Pra e folmja e Dibrës, sidomos në zonat veriore të saj, bën pjesë në grupin e të folmeve të gegërishtes qëndrore, siç duket edhe në tiparet e përbashkëta vokaliqe që sapo shqyrtuam me të folmet e tjera geqe veriore e verilindore. Nga ana tjetër theksuam se te folmet e zonave jugore të Dibrës kanë mjaft karakteristika të përbashkëta me gegërishten juglindore dhe jugore, prandaj themi se; E folmja e Dibrës është ura lidhëse mes gegërishtes veriore dhe asaj jugore. Ndonëse kjo e folme ka lidhje dhe afri me të folme të tjera që e rrethojnë, ajo karakterizohet dhe prej një varg veçorish gjuhësore që janë specifike për këtë të folme. Prandaj, edhe vënia në dukje e këtyre veçorive përbën interes dialektor jo vetëm për këtë të folme, por edhe për të folmet me të cilat e folmja e Dibrës ka pasur lidhje gjuhësore, sikundër edhe për mbarë dialektologjinë shqiptare.